



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio nr. 636/2023

**Përfshirja e standardeve të zbatueshme të fushës së të drejtave të njeriut në tekstet
shkollore të arsimit të mesëm të lartë në Kosovë**

Për: Znj. Arbërie Nagavci, ministre
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Kopje: Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 15 gusht 2024

QËLLIMI I RAPORTIT

1. Ky raport ka për qëllim vlerësimin e nivelit të përfshirjes së standardeve që janë në zbatim në fushën e të drejtave të njeriut në tekstet shkollore të arsimit të mesëm të lartë¹ në sistemin arsimor në Republikën e Kosovës.

2. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, roli dhe kompetencat e Avokatit të Popullit janë: *“1. Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.”*² *2. Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës.”*³ *Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”*⁴ Mbrojtja, mbikëqyrja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë, nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, të institucioneve dhe të personave apo të autoriteteve të tjera, të cilat ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës, qëndron në thelb të misionit dhe është në përputhshmëri të plotë me rolin që ka dhe kompetencat që ia ka dhënë Kushtetuta dhe ligji.

3. Raporti është hartuar duke analizuar përmbajtjen e 19 teksteve shkollore të klasave 10, 11 dhe 12, të të gjitha drejtimeve të shkollave të mesme, si për gjimnaze shoqërore-gjuhësore, ashtu edhe për gjimnaze natyrore. Duke qenë se qëllimi i raportit është i fokusuar ekskluzivisht në fushën e të drejtave të njeriut, rrjedhimisht hetimi është zhvilluar për tekstet e lëndëve shkollore nga shkencat shoqërore dhe fushat humane në përgjithësi, të tilla si: lënda për gjuhën amtare, për letërsinë, për historinë, për filozofinë, logjikën, psikologjinë, sociologjinë dhe edukatën qytetare.

4. Duke qenë se sistemi arsimor në përgjithësi, specifikisht arsimi i mesëm i lartë, është mekanizmi më gjithëpërfshirës dhe më determinues në edukimin e nxënësve, përfillja e standardeve të fushës së të drejtave të njeriut dhe përfshirja e tyre në tekstet shkollore janë dy elemente shumë përcaktuese për edukimin e nxënësve mbi të drejtat e njeriut. Rrjedhimisht, ajo çfarë mësojnë dhe si mësojnë nxënësit në shkollë për të drejtat e njeriut përmes teksteve shkollore janë determinuese për atë se çfarë do të mendojnë nxënësit edhe në vitet në vijim për të drejtat e njeriut.

TË DREJTAT E NJERIUT DHE TEKSTET SHKOLLORE

5. Të drejtat e njeriut janë të drejta qenësore të të gjitha qenieve njerëzore, pavarësisht racës, gjinisë, etnisë, kombësisë, gjuhës, religjionit apo ndonjë përkatësie a statusi tjetër. Të drejtat e njeriut janë konceptuar si parime dhe norma që u atribuohen të gjithë njerëzve, nisur nga vetë esenca e qenies njerëzore si e tillë. Rrjedhimisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë universale dhe të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit

¹ Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4.: *“Niveli 3: Arsimi i mesëm i lartë që zgjat tri (3) vite, varësisht nga kurrikulumi i përcaktuar nga Ministria (normalisht prej moshës pesëmbëdhjetë (15) vjeçare, faza 5 dhe 6 e KKK), përfshirë gjimnazin, shkollën e mesme profesionale, shkollën e muzikës dhe atë të artit.”*

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132, paragrafi 1.

³ Po aty, neni 132, paragrafi 2.

⁴ Po aty, neni 132, paragrafi 3.

juridik të Republikës së Kosovës.⁵ Me qëllim të kodifikimit dhe mbrojtjes ligjore të të drejtave të njeriut, veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore, janë hartuar dhe janë miratuar një mori konventash, rezolutash, ligjesh dhe dokumentesh të tjera ndërkombëtare, rajonale dhe lokale, për t'i garantuar dhe mbrojtur edhe ligjërisht të drejtat e njeriut.⁶

6. Kultivimi dhe promovimi i kulturës së mbrojtjes së të drejtave të njeriut në institucionet shkollore në botë mbetet preokupim i shumë organizatave ndërkombëtare që merren me këtë fushë. “Shkolla Miqësore për të Drejtat e Njeriut” është vetëm një nga iniciativat të cilën e ka nisur organizata ndërkombëtare për të drejtat e njeriut Amnesty International. Kjo nismë ka për qëllim që rëndësinë e të drejtave të njeriut ta vendosë në thelb të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke promovuar në të njëjtën kohë respektin e ndërsjellë ndaj diverzitetit, barazisë dhe gjithëpërfshirjes.⁷ Qasjen e të drejtave të njeriut përmes planprogrameve mësimore në shkolla, organizata Amnesty International ua ka dhënë shkollave me promovimin e idesë së “Shkolla Miqësore për të Drejtat e Njeriut”, e cila ka për qëllim që të kalojë përtej klasave të mësimi dhe që fëmijët t'i promovojnë të drejtat e njeriut në familje dhe në komunitetin e tyre. Ky projekt tani është bërë pjesë e shkollave në 22 vende të botës, duke përfshirë Danimarkën, Ganën, Moldavinë, Poloninë, Britaninë e Madhe, Italinë etj.⁸ Shtetet mund të bëhen pjesë e kësaj nisme përmes mbështetjes me materialet e nevojshme nga vetë organizata Amnesty International dhe përmes aplikimit në platformat elektronike të kësaj organizate.

7. Mbrojtja e të drejtave të njeriut shtrihet nga komuniteti e deri të organizatat ndërkombëtare, përfshirja e të cilave synohet ta përfshijë tërë botën. Veprimtaria e këtyre organizatave shtrihet nga mbrojtja e të drejtave themelore të njeriut e deri te të drejtat e mbrojtjes së pasurive materiale. Kur flitet për fushën e të drejtave të njeriut, ajo paraqet një traditë të gjatë dhe të larmishme, e cila përbëhet nga liritë themelore dhe të drejtat e njeriut deri te një mori kategorish dhe nënkategorish, si: të drejtat e fëmijëve; eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit racial, gjinor, religjioz dhe kulturor; të drejtat politike dhe civile; e drejta e besimit dhe manifestimit të religjionit; e drejta e votës etj.

8. Kombet e Bashkuara, përkundër mbështetjes së sigurisë globale, i qëndrojnë prapa idesë se zhvillimi dhe siguria janë të pandashme dhe asnjëra nuk ka kuptim pa respektim të të drejtave të njeriut⁹, ide kjo mbi të cilën e hartuan Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut në vitin 1948. Në vitin 2006, Kombet e Bashkuara themeluan Këshillin për të Drejtat e Njeriut, i cili përbëhet nga 47 shtete, që kanë për qëllim promovimin, mbrojtjen dhe adresimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut në çdo vend të botës. Një institucion tjetër që e mbulon këtë fushë është edhe Zyra e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (UNOHCHR), Komiteti Internacional Koordinues për Institucionet Kombëtare për

⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 21, paragrafi 1.

⁶ Frederick Quinn, *Human Rights and You*, Poland: OSCE/ODIHR, 1997.

⁷ Amnesty International, “Human Rights Friendly Schools”, Amnesty International, 26 June 2023, par. 1-4, in: <https://www.amnesty.org/en/human-rights-education/human-rights-friendly-schools/> in (qasur më 4 shkurt 2024).

⁸ Amnesty International, “Human Rights Friendly Schools.” Amnesty International, 26 June 2023, par. 5 <https://www.amnesty.org/en/human-rights-education/human-rights-friendly-schools/>

⁹ Human Rights Commission, “Intergovernmental Human Rights Organizations” Cayman Islands, in: [https://www.humanrightscommission.ky/intergovernmental-human-rights-organisations#:~:text=UN%20Human%20Rights%20Council%20\(UNHRC,and%20making%20recommendations%20on%20them](https://www.humanrightscommission.ky/intergovernmental-human-rights-organisations#:~:text=UN%20Human%20Rights%20Council%20(UNHRC,and%20making%20recommendations%20on%20them) (qasur më 4 shkurt 2024).

Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës, Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO) etj.

9. Në raportin për edukimin mbi të drejtat e njeriut në sistemet shkollore të Evropës, Azisë Qendrore dhe Amerikës Veriore, i përpiluar në vitin 2006 nga Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSBE-së, e ku janë analizuar praktikat dhe aktivitetet që organizohen në shkolla në kuadër të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut, përmendet ndër të tjerash edhe Kosova, e cila ka qenë pjesë e praktikave që kanë mundur zhvillimin e aktiviteteve jashtëshkollore me anë të pjesëmarrjes së nxënësve në Klube të të Drejtave të Njeriut dhe shpërndarjes së broshurave mbi të drejtat e njeriut dhe ligjebe për to. Librat u shpërndanë te rreth 324 fëmijë të shkollave fillore dhe të mesme.¹⁰ Përveç fëmijëve të nacionalitetit shqiptar, në projekt u përhshinë edhe fëmijë që u përkisnin nacionaliteteve, si: boshnjak, kroat, rom, serb dhe turk. Nga atëherë e deri më sot, në Republikën e Kosovës dhe konkretisht në sistemin arsimor publik të saj, ka pasur avancim të ndjeshëm dhe shumë më gjithëpërfshirës në format e edukimit të nxënësve mbi të drejtat e njeriut. Rrjedhimisht, ky raport analizon se cili është niveli i përfshirjes dhe aplikueshmërisë së standardeve të fushës së të drejtave të njeriut në tekstet shkollore të arsimit të mesëm të lartë në Kosovë.

BURIMET DHE METODOLOGJIA

10. Në sistemet publike të edukimit, tekstet shkollore janë librat me ndikimin më të madh dhe më të gjerë në shoqërinë e një vendi. Ato përcjellin frymën e sistemeve të vlerave dhe të traditave kulturore të një shoqërie, por edhe vizionin e shtetit përkatës për qytetarët e tij. Si gjatë shkollimit formal të fëmijëve në shkollimin fillor ashtu edhe të fëmijëve në shkollimin e mesëm të lartë, roli arsimor dhe ndikimi edukues i teksteve shkollore është gjithëpërfshirës dhe tejet përcaktues në formësimin kulturor të të rinjve përgjatë gjithë jetës. Duke përjashtuar njohuritë profesionale të marra më pastaj dhe ato mbi fushat e studimit të ata që ndjekin studimet universitare, shumica e nxënësve përgjithësisht nuk i tejkalojnë ose nuk i zëvendësojnë apo nuk i plotësojnë njohuritë e tyre bazike përtej atyre të marra gjatë shkollimit të ciklit fillor dhe të mesëm. Ato çfarë lexojnë, ato çfarë mësojnë dhe ato për çfarë u kërkohet nxënësve të mendojnë në shkollë janë determinuese për formimin kulturor dhe formësimin qytetar të tyre. Për këtë arsye, hartimi i programeve dhe i kurrikulave prej nga përpilohen tekstet shkollore, shpërfaq edhe përfytyrimin e institucioneve shtetërore për shoqërinë e tyre. Tekstet shkollore në përgjithësi, veçanërisht ato të fushave shoqërore, e reflektojnë perceptimin e komunitetit për veten dhe hierarkinë e vlerave kulturore dhe humane të tij. Rrjedhimisht, tekstet shkollore gjithmonë janë edhe një korpus unik librash, përmes të cilave autoritetet shtetërore i konstruktojnë identitetet kolektive të shoqërisë dhe shtrojnë rrugë nga sugjerohet ecja e njerëzve. Disa nga mitet më të ngulitura në vetëdijen kolektive të komuniteteve dhe shoqërive janë konstrukte të prodhuara dhe të kultivuara pikërisht nga tekstet shkollore.¹¹

11. Ky raport është vazhdimësi e raportit të ngjashëm paraprak të Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili është fokusuar te prania dhe përdorimi i gjuhës së urrejtjes në tekstet shkollore

¹⁰ OHCHR, "Human Rights Education in the School Systems of Europe, Central Asia and North America: A Compendium of Good Practice", Poland: 2009, f.1, 94, 141, 142.

<https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Publications/CompendiumHRE.pdf>

¹¹ Durim Abdullahu, *Myths in Kosovar Textbooks: History in the Service of Identity Construction*, in c. Lichnofsky, E. Pndelejmoni, D. Stojanov, *Myths and Mythical Spaces: Conditions and Challenges for History Textbooks in Albania and South-Eastern Europe*, Gottingen: V&T Press, 2018, ff. 34-55.

të ciklit të ulët në Kosovë.¹² Ndryshe prej tij, ky raport është hartuar duke hulumtuar përfshirjen e standardeve të aplikueshme në fushën e të drejtave të njeriut në tekstet shkollore të arsimit të mesëm të lartë në Kosovë. Më tutje, ky raport është i përqendruar te kërkimi i nivelit të përfshirjes së standardeve për fushën e të drejtave të njeriut në librat shkollor të arsimit të mesëm të lartë në sistemin shkollor publik në Republikën e Kosovës.

12. Duke u nisur nga ideja fillestare se të drejtat e njeriut janë të trajtueshme si fushë, por edhe të cenueshme në aspektin se si njerëzit flasin dhe shkruajnë për to, kryesisht në kuadër të lëndëve shkollore nga fushat e shkencave shoqërore, gjuhësore dhe humane, mostra e përzgjedhur e teksteve nëpërmjet të cilave është hartuar ky raport është pothuajse totale. Për formimin e kësaj mostre janë përfshirë të gjitha lëndët shkollore të fushave shoqërore, gjuhësore dhe humane, që gjithsej janë tetë: Gjuha shqipe, Letërsia, Historia, Filozofia, Logjika, Sociologjia, Psikologjia dhe Edukata qytetare. Së këndejmi, mostra e teksteve shkollore prej të cilave është hartuar ky raport, përbëhet prej tri tekstesh nga Gjuha shqipe, katër nga Letërsia, tri nga Historia, dy nga lënda Filozofi dhe Logjikë, dy nga Sociologjia, dy nga Psikologjia dhe tri tekste nga lënda Edukatë qytetare. Nga kjo rezulton se numri total i librave të mostrës së këtij raporti është 19 tekste shkollore, të listuara me tituj dhe emrat e autorëve si në vijim:

- 12.1. Gjuha shqipe 10 - Linda Mëniku; Idriz Metani; Rita Petro; Begzad Baliu;
- 12.2. Gjuha shqipe 11 - Linda Mëniku; Aljula Jubani; Rita Petro; Brgzad Baliu;
- 12.3. Gjuha shqipe 12 - Xhevat Lloshi; Linda Mëniku; Begzad Baliu;
- 12.4. Letërsia 10 - Sabri Hamiti; Kujtim M. Shala; Kujtim Rrahmani; Nysret Krasniqi;
- 12.5. Letërsia 11 – (për gjimnazin e shkencave shoqërore – gjuhësore) - Sabri Hamiti; Ardian Marashi; Nysret Krasniqi;
- 12.6. Letërsia 11 – (për gjimnazin e shkencave natyrore) - Sabri Hamiti; Ardian Marashi; Nysret Krasniqi;
- 12.7. Letërsia 12 - (për gjimnazin e shkencave shoqërore- gjuhësore dhe natyrore)- Sabri Hamiti, Nysret Krasniqi; Ardian Marashi;
- 12.8. Historia 10 - Arben Hajdari; Sedat Baraliu; Azdren Shala;
- 12.9. Historia 11 - (për gjimnazin shoqëror-gjuhësor) - Sedat Baraliu; Azdren Shala; Arben Hajdari;
- 12.10. Historia 12 - (për gjimnazin e shkencave shoqërore-gjuhësore) - Zahir Kastrati; Bekim Paci;
- 12.11. Filozofi dhe logjikë 11 - Blerim Latifi; Yllka Plasari (Myftiu); Ilirjan Meta;
- 12.12. Filozofi dhe logjikë 12 - Yllka Plasari (Myftiu); Ilirjan Meta;
- 12.13. Sociologji 11 - (gjimnazi i shkencave shoqërore-gjuhësore) - Muhamet Q. Mazreku;
- 12.14. Sociologji 12 - Muhamet Mazreku;

¹² Institucioni i Avokatit të Popullit, Gjuha e urrejtjes në tekstet shkollore të ciklit të ulët në Kosovë, Prishtinë: IAP, 11.8.2023, në <https://oik-rks.org/2023/08/11/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-1472021-gjuha-e-urrejtjes-ne-tekstet-shkollore-te-ciklit-te-ulet-ne-kosove/>

- 12.15. Psikologji 11 - (për gjimnazin shoqëror-gjuhësor dhe të shkencave natyrore) - Blerta Perolli Shehu; Lediana Xhakollari; Arben Hoti; Adelina Kakija;
- 12.16. Psikologji 12 - (gjimnazi i shkencave shoqërore-gjuhësore) - Blerta Perolli Shehu; Lediana Xhakollari;
- 12.17. Edukatë qytetare 10 - Lumnie Behrami; Juliana Ajdini; Veronika Duci; Eljana Dosti;
- 12.18. Edukatë qytetare 11 - Egzona Hyseni - Kllokoqi; dhe
- 12.19. Edukatë qytetare 12 - Egzona Hyseni.

13. Për hartimin e këtij raporti, përveç teksteve shkollore, janë përdorur edhe burime të tjera relevante nga teoritë e edukimit dhe studimet mbi tekstet shkollore, si dhe një numër tekstesh dhe dokumentesh nga fusha e të drejtave të njeriut. Nëpërmjet këtyre të fundit është ndërtuar një themel teorik mbi bazën e të cilit janë hetuar tekstet shkollore të listuara më lart, për të parë përfshirjen e standardeve të aplikueshme në fushën e të drejtave të njeriut.

14. Nisur nga qëllimi i këtij raporti për vlerësimin e nivelit të përfshirjes së standardeve të aplikueshme në fushën e të drejtave të njeriut në tekstet shkollore të arsimit të mesëm të lartë në sistemin arsimor në Republikën e Kosovës, i tërë hetimi për këtë raport është realizuar mbi rrafshin teorik dhe diskursiv. Pra, metodologjia e aplikuar për këtë raport është analiza e teksteve shkollore, përkatësisht leximi kritik i teksteve shkollore, duke i dekonstruktuar diskursat e tyre, duke e analizuar dhe shqyrtuar përmbajtjen e teksteve në raport me fushën e të drejtave të njeriut. Për ta përplotësuar hetimin e përfshirjes së fushës së të drejtave të njeriut në librat që përdoren në sistemin publik shkollor të arsimit të mesëm të lartë në Kosovë, është marrë në shqyrtim edhe ikonografia e këtyre librave. Pra ilustrimet dhe imazhet e përfshira në këto tekste shkollore i janë nënshtruar gjithashtu një analize vizuale, për ta parë përshtatshmërinë e tyre me pjesët tekstuale, në dritë të aplikueshmërisë së fushës së të drejtave të njeriut. I tërë raporti është rezultat i tri burimeve tekstuale dhe i një metodologjie që rrjedh nga dy teori interpretuese. Burimet janë mostra e teksteve shkollore e përbërë prej 19 librash shkollorë; teoritë e filozofisë së edukimit mbi hartimin e teksteve shkollore; si dhe studimet dhe dokumentet në fushën e të drejtave të njeriut. Ndërsa metodologjia derivon nga teoritë e analizës së tekstit dhe analizës vizuale.

ANALIZA E TEKSTEVE SHKOLLORE: GJETJE DHE KONSTATIME

15. Përfshirja dhe aplikueshmëria e standardeve të fushës së të drejtave të njeriut në tekstet shkollore është e paracaktuar dhe e formësuar varësisht nga lëndët shkollore. Fusha e të drejtave të njeriut tematizohet ndryshe në lëndën e historisë, duke u reflektuar në avancimin e lëvizjeve shoqërore dhe proceseve historike për liritë dhe të drejtat e njeriut, nga shekulli XIX e tutje. Në anën tjetër, ndonëse jo gjithmonë në mënyrë të drejtpërdrejtë, standardet e fushës së të drejtave të njeriut sfidohen pozitivisht nga reflektimet filozofike dhe nga sistemet e ndryshme të logjikës, të lënda Filozofi dhe logjikë. Ndërkaq një dimension shumë më specifik, që ndërlidhet me fushën e të drejtave të njeriut, haset te tekstet shkollore të lëndës së Psikologjisë. Natyrshëm, për shkak të esencës së theksuar sociale që ka thelbi i fushës së të drejtave të njeriut dhe natyrës së kategorive të saj që në tërësinë e tyre paraqesin marrëdhënie ndërpersonale brenda komunitetesh të stadeve dhe strukturave të ndryshme shoqërore, fusha e

të drejtave të njeriut vihet në pah në trajtat më të plota të saj te lëndët shkollore si: Sociologjia dhe Edukata qytetare.

16. Përkitazi me këtë përshkallëzim të trajtave të tematizimit dhe problematizimit të çështjeve të fushës së të drejtave të njeriut, në varësi të shkencave shoqërore dhe fushave humane, gjetjet e këtij raporti janë sistemuar duke i ndarë sipas lëndëve shkollore. Kjo është bërë edhe për lehtësi referimi ndaj gjetjeve të raportit, përkitazi me tekstet shkollore ku janë nxjerrë këto gjetje.

Gjuha shqipe, Letërsia dhe Historia

17. Nga numri i përgjithshëm i librave të mostrës së këtij raporti, tekstet nga lëndët Gjuha shqipe, Letërsia dhe Historia përbëjnë gjithsej 10 libra. Në përpjesëtim me numrin total të teksteve të analizuara, 10 nga 19 tekste rezultojnë të jenë 52% e teksteve të analizuara për këtë raport. Arsyeja përse gjysma e teksteve shkollore të trajtuara për hartimin e këtij raporti janë grupuar në një kategori, vjen nga fakti se tekstet e këtyre tri lëndëve shkollore, si për shkak të natyrës së fushave, ashtu edhe për shkak të kurrikulave mbi të cilat janë hartuar, përgjithësisht nuk e afektojnë fushën e të drejtave të njeriut. Duke u nisur nga rrjedha logjike formale që lënda Gjuhë shqipe derivon si lëndë për gjuhën amtare, por e organizuar në bazë të shkencave të linguistikës, temat dhe çështjet e njësive mësimore të saj, të lidhura kryesisht me gramatikën, me morfologjinë, me sintaksën, me leksikografinë etj., nuk kanë përmbajtje që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me fushën e të drejtave të njeriut. Kështu, të tre librat e lëndës Gjuha shqipe, ai i klasës së 10-të,¹³ i klasës së 11-të¹⁴ dhe të 12-të¹⁵ kanë përmbajtje të vogël për t'u trajtuar në raport me të drejtat e njeriut.

18. I njëjti parim vlen edhe për katër tekstet e shqyrtuara për këtë raport, nga lënda Letërsi. Meqë tekstet e kësaj lënde shkollore janë të përbëra përgjithësisht nga tekste letrare, përkatësisht nga poezi, tregime dhe fragmente tekstesh nga novela dhe romane të letërsisë shqipe dhe të letërsisë botërore, njësitë mësimore, gjegjësisht pjesët e leximit të lënda e Letërsisë, gjithashtu nuk e afektojnë fushën e të drejtave të njeriut. Aq më tepër që lënda e Letërsisë është e konceptuar mbi trashëgiminë letrare, që në thelb është trashëgimi artistike. Së këndejmi, tekstet shkollore të lënda e Letërsisë gëzojnë një lloj mburoje apo amnistie e thënë në mënyrë të kushtëzuar, për shkak se tekstet e kësaj lënde janë krijime letrare artistike dhe si të tilla, edhe në rastet kur përmbajnë situata fiktive letrare dhe dialogje mes personazheve që si tematikë mund të lidhen me të drejtat e njeriut, ato nuk mund t'i nënshtrohen një leximi kritik literar në dritën e fushës së të drejtave të njeriut. Në këtë kategori është fjala për gjithsej katër tekste të lëndës Letërsi, për klasën e 10-të¹⁶, dy tekste për klasën e 11-të¹⁷ dhe teksti i klasës së 12-të.¹⁸

¹³ Linda Mëniku, Idriz Metani, etj., Gjuha shqipe 10 (për gjimnazin e shkencave shoqërore-gjuhësore dhe natyrore), Prishtinë: Albas, 2022.

¹⁴ Linda Mëniku, Aljula Jubani, etj., Gjuha shqipe 11 (për gjimnazin e shkencave shoqërore-gjuhësore dhe natyrore), Prishtinë: Albas, 2020.

¹⁵ Xhevat Lloshi, Linda Mëniku, Gjuha shqipe 12 (për gjimnazin e shkencave shoqërore-gjuhësore dhe natyrore), Prishtinë: Albas, 2022.

¹⁶ Sabri Hamiti, Kujtim Shala, etj., Letërsia 10, Prishtinë: 2023

¹⁷ Sabri Hamiti, Ardian Marashi, etj., Letërsia 11 (për gjimnazin e shkencave shoqërore-gjuhësore), Prishtinë: Albas, 2019; Sabri Hamiti, Ardian Marashi etj., Letërsia 11 (për gjimnazin e shkencave natyrore), Prishtinë: Albas, 2020.

¹⁸ Sabri Hamiti, Nysret Krasniqi, etj., Letërsia 12 (për gjimnazin e shkencave shoqërore-gjuhësore dhe natyrore), Prishtinë: Albas, 2021.

19. Duke qenë se historia si fushë është e shpërndarë te lënda e Historisë sipas parimit kohor të rrjedhave të ngjarjeve sipas radhës kronologjike, vetëm te një pjesë e kufizuar e njësive mësimore nga lënda e Historisë hyjnë në funksion parime dhe standarde të të drejtave të njeriut. Kështu librat Histori 10¹⁹ dhe Histori 11²⁰ nuk kanë asnjë njësi mësimore që ndërlidhet me të drejtat e njeriut, sepse sipas kurrikulave, ato tekste shkollore përfshijnë mësimet historike nga periudha e antikitetit dhe e mesjetës. Më pranë periudhës kur të drejtat e njeriut janë artikuluar historikisht si të tilla, janë temat e trajtuara në tekstin Histori 12, meqë njësitë mësimore të tij arrijnë deri te ngjarje të historisë bashkëkohore. Kështu, kapitujt përmbyllës të këtij libri, gjegjësisht kapitujt 19, 20 dhe 21, mbajnë titujt: Siguria kolektive (OKB, Këshilli i Evropës, KSBE/OSBE); Globalizmi dhe sfidat e tij; dhe Integrimet evropiane. Megjithatë këta tre kapituj tematizojnë fenomene globale dhe institucione që lidhen drejtpërdrejt me të drejtat e njeriut, sidomos me mbrojtjen dhe avokimin e tyre, në këta kapituj nuk është shkruar praktikisht asgjë për të drejtat e njeriut.²¹ Meqë libri Histori 12 ka njësi mësimore për periudha historike kur më së shumti janë zhvilluar politika nacionale dhe globale për të drejtat e njeriut, do të ishte shumë e natyrshme dhe e përshtatshme që në një kapitull të veçantë të ofrohej një historik i sfidave dhe i avancimit të të drejtave të njeriut, i institucioneve ndërkombëtare dhe i konventave, rezolutave dhe dokumenteve prej ku mbrojnë të drejtat e njeriut, por edhe i rasteve më ekstreme të shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Edukatë qytetare

20. Tekstet shkollore të lëndës Edukata qytetare janë librat me përmbajtjen më të dendur të njësive mësimore, që në mënyrë të drejtpërdrejtë tematizojnë fushën e të drejtave të njeriut. Në mostrën e librave të analizuar për këtë raport, nga 19 tekste sa janë gjithsej, 3 prej tyre janë të lëndës Edukatë qytetare. Rreth 20% e tërë përmbajtjes së tekstit Edukatë qytetare 10 ka përmbajtje të pastër të mësimave nga fusha e të drejtave të njeriut. Ndërkaq te libri Edukatë aytetare 11, nga 28 njësi mësimore sa i ka gjithsej ky libër, 7 janë specifikisht për të drejtat e njeriut. Nga kjo rezulton që 25% e këtij libri ka përmbajtje për të drejtat e njeriut. Kurse te teksti Edukatë aytetare 12, rreth 10% e njësive mësimore kanë tematikë të drejtpërdrejtë nga fusha e të drejtave të njeriut, kurse elemente dhe aspekte që lidhen me të drejtat e njeriut hasen të shpërndara edhe në njësi të tjera mësimore brenda këtij teksti shkollor.

Edukatë qytetare 10

21. Në këtë libër, te Tematika nr. 2 e titulluar “Vendimmarrja institucionale”, njësia e 7-të mësimore i është kushtuar një prej të drejtave themelore politike, që është e drejta e votës. Me titull “Votimi dhe e drejta e votuesve”, në këtë njësi mësimore janë sqaruar në mënyrë të thukët, në dy faqe, të gjitha të drejtat e votuesve, procedurat ligjore të zgjedhjes dhe të të zgjedhurit apo të kandidimit, rrethanat eventuale në të cilat mund të humben këto të drejta dhe rëndësia e ushtrimit të kësaj të drejte.²² Edhe më tutje, ky libër ka njësi mësimore shumë me nivel të lartë të përfilljes dhe përfshirjes së standardeve dhe njohurive mbi fushën e të drejtave të njeriut. Mbase kulmi i tyre është njësia e 9-të e Tematikës nr. 2, e titulluar

¹⁹ Arben Hajdari, Sedat Baraaliu etj., Histori 10 (për gjimnazin shoqëror-gjuhësor), Prishtinë: Albas, 2020.

²⁰ Sedat Baraaliu, Azdren Shala etj., Histori 11 (për gjimnazin shoqëror-gjuhësor), Prishtinë: Albas, 2019.

²¹ Zahir Kastrati, Bekim Paci, Histori 12 (për gjimnazin e shkencave shoqërore-gjuhësore), Prishtinë: Albas, 2023, fq. 203-220.

²² Lumnie Behrami, Juliana Ajdini etj., Edukatë qytetare 10, Prishtinë: Albas, 2021, fq. 37-39.

“Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive në shkollën time (Projekt)”, që siç kuptohet edhe nga ky titull, është konceptuar në formën e një projekti. Ky projekt është ndërtuar në bazë të një pyetësi me 10 pyetje, me nga katër përgjigje të përshkallëzuara: jo/asnjëherë; rrallë; shpesh; po/gjithmonë.²³ Plotësimi i këtij pyetësi është një gjetje kreative që i angazhon nxënësit të mendojnë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre brenda shkollës ku ata janë duke u shkolluar.

22. Në tekstin Edukatë aytetare 10, e tërë Tematika nr. 5, që mban titullin “Identiteti dhe diversiteti kulturor”, me gjithsej tri njësi mësimore, u është kushtuar tërësisht të drejtave të njeriut. Njësia e parë “Identiteti si pjesë e një grupi dhe e një komuniteti”, është përqendruar te përkufizimi i identitetit, te të qenit të ndryshëm nga njëri-tjetri, te pranimi dhe respektimi i ndërsjellë i tjetrit, si dhe te identiteti grupor. Këto tema ndihmojnë në edukimin e nxënësve me linjat që përkufizojnë identitetin personal si të shquar për nga identiteti i tjetrit dhe ai kolektiv. Megjithatë, ky mësim çalon në definimin e qartë, plotësisht të qartë, të koncepteve themelore si vetë identiteti si diçka e negociueshme, si një përkatësi me shumë shtresa që ndryshon në varësi nga koha dhe rrethanat. “Të ndryshëm, por të barabartë” është titulluar mësimi i dytë i këtij kapitulli. Ai hapet me një pjesë për diversitetin e shkruar me shumë kujdes, por mbyllet me një pjesë të titulluar “Gjithëpërfshirja”, te i cili ka një paragraf problematik në të cilin shkruhet: “*Në Kosovë, shkaqet që sjellin përjashtimin social janë të lidhura ngushtë me shkallën e varfërisë, përkatësinë etnike, gjininë, vendbanimin, aftësinë e kufizuar, moshën, orientimin seksual, statusin e punësimit apo shkaqe të tjera që përjashtojnë njerëzit nga një sërë procesesh dhe mundësish ekonomike dhe sociale.*”²⁴ Duke i përgjithësuar shkaqet e përjashtimit social, ky paragraf lë shumë hapësirë për keqkuptime, sepse vërejtjet në të janë të pamjaftueshme për ta mbështetur dhe sqaruar deri në fund argumentimin e këtij konstatimi. Duke mos u lëshuar specifikisht në rrethanat sociale, por edhe në kontekstet historike që i kanë prodhuar dhe që i mirëmbajnë stereotipat shoqërorë, që sjellin përjashtime sociale, ky paragraf ndërton një panoramë të pasaktë, sepse të paplotë për realitetet sociale në Kosovë.

Edukatë qytetare 11

23. Nga pesë kapitujt e këtij teksti, kapitulli i 3-të është rezervuar për të drejtat e njeriut, siç kuptohet edhe nga titulli i tij: “Edukimi për qytetari dhe të drejtat e njeriut”. Por në hapje të këtij kapitulli, te njësia e parë mësimore, që është titulluar “Multikulturalizmi”, përmbajtja e tij nuk i përgjigjet temës përkatëse. Te ky mësim, teksti nuk arrin ta sqarojë realisht dhe kuptueshëm çfarë është multikulturalizmi. Në këtë mësim, multikulturalizmi paraqitet gabimisht si një term për të përshkruar më shumë rivalitetin mes kulturave dhe një lloj lufte për dominim kulturor brenda një shoqërie, sesa si një term për të përshkruar larushinë kulturore si pasuri kulturore dhe si një term për të emërtuar bashkëjetesën paqësore të kulturave të ndryshme në të njëjtin vend apo në të njëjtën shoqëri. Te ky mësim janë shkruar edhe disa fjali me pretendime të paqëndrueshme dhe të pambështetura, që e deformojnë krejtësisht konceptin e “multikulturalizmit”. Aty shkruhet: “*Europa dhe disa shtete perëndimore kanë refuzuar të menaxhojnë multikulturalizmin për shkak të funksionit kulturor mjaft të komplikuar. Disa popuj nuk duan të asimilohen ose të integrohen në kulturën kombëtare të këtyre kombeve të tjera. Për zgjidhjen e kësaj detyre është e nevojshme të*

²³ Po aty, fq. 40-41.

²⁴ Po aty, fq. 72.

zhvillohet dhe të zbatohet program ndërkombëtar i tranzicionit nga tipi “Homo Sapiens” te njerëzit me shumë kultura në të gjithë botën.” Këto formulime janë krejt absurde dhe të pabazuara shkencërisht. Pohimi se në Evropë dhe në disa shtete perëndimore është refuzuar multikulturalizmi dhe se disa popuj nuk duan të asimilohen, përcjellin pretendime të pavërteta historikisht dhe të pasakta. Evropa ka qenë qendra ku është ngjizur dhe kultivuar multikulturalizmi, kurse ky term, pra “multikulturalizmi”, nuk nënkupton asimilimin e popujve. Shumë më i çuditshëm dhe krejt absurd në vetvete është propozimi që për ta zgjidhur këtë detyrë “është e nevojshme të zhvillohet dhe të zbatohet program ndërkombëtar i tranzicionit nga tipi “Homo Sapiens” te njerëzit me shumë kultura në të gjithë botën.” Ky propozim teleologjik për historinë e species njerëzore ka trajtën e një lloj “komploti” global për orientimin e gjithë njerëzimit dhe nuk është i përshtatshëm në një tekst shkollor që mëton t’i edukojë nxënësit mbi të drejtat e njeriut.²⁵

24. Tutje, te njësia pasuese “Të drejtat e njeriut dhe historia e tyre”, te kapitulli “Si lindën të drejtat e njeriut”, është shkruar: “*Themelet e të drejtave të njeriut janë vënë së pari në Kartën e Magnës, shkruar nga mbreti Xhon i Anglisë, e nënshkruar më 15 qershor 1215. Kjo kartë siguron parimet e përgjithshme bazë të të drejtave të njeriut*”. Origjina apo themelet e të drejtave të njeriut nuk mund të kërkohen dhe as të gjenden te Karta Magna dhe pohimi se ajo “kartë i siguron parimet e përgjithshme bazë të të drejtave të njeriut” është historikisht i paqëndrueshëm. Megjithatë Karta Magna konsiderohet si një dokument i rëndësishëm për kufizimin e të drejtave dhe ushtrimin abuziv të tyre nga mbreti i Anglisë, ajo nuk është dokument themeltar i të drejtave të njeriut, pasi në thelb Karta Magna ishte një marrëveshje e detyrueshme e imponuar nga lordët anglezë për të arritur paqe dhe rregulluar raportet mes tyre dhe mbretit të Anglisë, e ku mbreti Xhon zotohej t’i mbronte të drejtat e kishës, t’i mbronte baronët anglezë nga burgosja e paligjshme dhe të kishin qasje të shpejtë në sistem të drejtësisë.²⁶ Madje, Karta Magna është përfshirë edhe në mësimin pasues “Dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”, duke u listuar mes dokumenteve të rëndësishme për të drejtat e njeriut. Aty janë listuar nëntë dokumente, por janë lënë jashtë disa nga më të rëndësishmet, si: Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit; Konventa Relative e Gjenevës për Mbrojtjen e Personave Civilë në Kohë Lufte; Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian etj. Një njësi mësimore, e cila pretendon të shtrojë historinë e të drejtave të njeriut, do të ishte shumë më shumë në vend të saj në librin e lëndës së Historisë sesa të Edukatës qytetare.

Edukatë qytetare 12

25. Nga të 19 librat e analizuar për hartimin e këtij raporti, libri Edukatë qytetare 12, i shkruar nga autorja Egzona Hyseni, ka më së shumti njësi mësimore për fushën e të drejtave të njeriut. Veçanërisht kapitulli Tematika 3: Raporti i individit me shoqërinë, në të cilën të katër njësitë mësimore të saj i kanë për tematikë të drejtat e njeriut dhe veçanërisht të drejtat e individit. Në përgjithësi ky kapitull ka një përmbajtje të arrirë për të drejtat e njeriut, përjashtoj disa formulime dhe shembuj të papërshtatshëm. Kështu, duke folur pikërisht për të drejtat e grave, në një paragraf është shkruar: “*Të drejtat e grave janë të drejta të njeriut nënkupton se grave u takojnë të gjitha të drejtat. Megjithatë, pothuajse kudo në botë, grave*

²⁵ Yuval Noah Harari, *Sapiens: Një histori e shkurtër e njerëzimit*, përkth., A. Ormeni, Tiranë: Botart, 2016.

²⁶ David Starkey, *Magna Carta: The Medieval Roots of Modern Politics*, Londër: Quercus, 2015.

dhe vajzave u mohohen ende të drejtat themelore.”²⁷ Pohimi se gati kudo në botë, grave dhe vajzave ende u mohohen të drejtat themelore, është jo i saktë dhe i paqëndrueshëm dhe do të duhej të riformulohej në: *“Megjithatë, pothuajse kudo në botë, respektimi dhe mbrojtja e këtyre të drejtave vazhdon të mbetet sfidë institucionale dhe shoqërore.”*

26. Teksti Edukatë qytetare 12 është libri me më së shumti njësi mësimore nga të gjithë librat e sistemit shkollor të ciklit të mesëm, ku fusha e të drejtave të njeriut është e përfshirë si tematikë e drejtpërdrejtë apo në kuadër të njësive mësimore ku flitet për lidhjet shoqërore, globalizmin, integrimin politik dhe ekonomik, integrimin kulturor etj. Ky është libri ku janë sqaruar më së miri koncepte, si: multikulturalizmi; të drejtat e individit në raport me shtetin; normat shoqërore; drejtësia tranzicionale; e drejta e azilit; kategoritë ekonomike, sociale dhe kulturore të të drejtave të njeriut; mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut; mbrojtja e pakicave; mbrojtja e refugjatëve etj.²⁸ Të gjitha këto tema janë shtjelluar në nivel të arrirë brenda këtij teksti dhe gjatë leximit analitik dhe kritik të këtyre njësive mësimore nuk është evidentuar ndonjë paragraf, fjali apo terminologji e papërshtatshme apo që për ndonjë arsye tjetër do t’ia vlente të përfshihej në këtë raport.

27. Përjashtim bën njësia e katërt mësimore te Tematika nr. 5. Kjo njësi mësimore është titulluar “Konflikti (Lufta) në Kosovë dhe gjykimet penale”. Qysh në titull aty është bërë një formulim i paqartë dhe i dykuptimshëm, ku janë përfshirë terme që nuk janë sinonime: “konflikt” dhe “luftë”. Përkundër titullit, brenda këtij mësimi, në kapitullin e parë është titulluar “Lufta në Kosovë”, kurse fjalia e parë e tij vazhdon kështu: *“Konflikti i armatosur në Kosovë ka filluar më 28 shkurt 1998 dhe ka përfunduar me nënshkrimin e marrëveshjes tekniko-ushtarake, e njohur si Marrëveshja e Kumanovës më 09 qershor 1999, midis NATO/KFOR-it dhe forcave të Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) dhe Republikës së Serbisë.”*²⁹ Ky formulim e minimizon luftën e zhvilluar në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, në një konflikt të armatosur. Pa i vendosur në një kontekst të qartë historik dhe shoqëror, te kjo njësi mësimore janë përmendur rastet e gjykimeve penale për luftën në Kosovë, duke listuar kryesisht në trajtë statistikash numrin e të dënuarve, sipas kriterit etnik, siç mund të shihet në këto fragmente: *“Prej këtyre 15 të akuzuarve lidhur me luftën e Kosovës, Tribunali i Hagës i ka shpallur fajtorë 8 persona (6 serbë dhe 2 shqiptarë)”*; *“Përgjatë punës së dy misionëve të lartpërmendura (UNMIK-ut dhe EULEX-it-D.A), kanë arritur që t’i dënojnë me vendim (aktgjykim) përfundimtar vetëm 40 persona, të cilët kanë kryer krime të luftës në Kosovë, prej tyre 34 shqiptarë, 5 serbë dhe 1 rom. Proceset ndaj kryerësve të krimeve të luftës në Kosovë janë duke u zhvilluar edhe pranë Gjykatës së Lartë në Beograd, Serbi. Në Serbi deri në fund të vitit 2019 janë dënuar 15 serbë dhe 2 shqiptarë.”*³⁰ Mungesa e kontekstit si dhe mbështetja e tepruar në statistika janë çorientuese, sepse krijojnë tendenca për barazimin e krimeve të luftës të kryera në Kosovë. Ky narracion vazhdon edhe te njësia mësimore “Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut”, ku te kapitulli “Gjenocidi”, ky term shpjegohet pa u adresuar rasti i Kosovës.

²⁷ Egzona Hyseni, Edukatë qytetare 12, Prishtinë: Albas, 2022, f. 34.

²⁸ Po aty, fq. 57-88.

²⁹ Po aty, fq. 70.

³⁰ Po aty, fq. 71-72.

Filozofi dhe logjikë; Sociologji

28. Tekstet shkollore të lëndës Filozofi dhe logjikë, për klasën e 11-të dhe të 12-të, ofrojnë një argument të shtuar lidhur me rëndësinë e lëndës së filozofisë në zhvillimin intelektual të nxënësve dhe përmirësimin e aftësive të mendimit kritik të tyre. Megjithatë në to nuk ka asnjë njësi mësimore që specifikisht i referohet fushës së të drejtave të njeriut, të të dy këta libra ka shumë njësi mësimore që u ndihmojnë nxënësve t'i sistemojnë mendimet e tyre sipas sistemeve logjike;³¹ t'i vënë në pikëpyetje dhe t'i marrin me dyshim mendimet e tyre apo të të tjerëve sipas skemave të skepticizmit; të përpiqen të arsyetojnë sipas mendimit filozofik të racionalizmit; të mendojnë në mënyrë kritike sipas mendimit filozofik të kritikizmit; dhe të diskutojnë mbi vetë esencën e qenies njerëzore, mbi njeriun, shoqëritë njerëzore etj. Të gjitha këto i pajisin nxënësit ose të paktën i orientojnë ata drejt një tradite tejet prodhimtare të mendimit, siç është filozofia, ku habia, reflektimi, të menduarit kritik dhe analitik, hipotezat, argumentimi, liria, etika dhe format e mendimit logjik janë gjithçka.³² Në librat e Sociologjisë të klasës së 11-të dhe të 12-të ka disa njësi mësimore dhe kapituj që i përfshijnë të drejtat e njeriut si fushë. Në tërësi është evidentuar një prani modeste e njësive mësimore.

Sociologji 11

29. Në kapitullin “Familja, martesë, seksualiteti dhe gjinia”, te njësia mësimore “Martesë e legalizuar-parakushtet, të drejtat dhe përgjegjësitë”, është shkruar: “*Martesa nuk mund të lidhet me një person që vuan nga një sëmundje psikike dhe nuk është i aftë të gjykojë normalisht martesën.*”³³ Kjo deklaratë përfshin të gjithë individët me çrregullime mendore sikur janë të paaftë për ta kuptuar martesën dhe diskriminon çdo person me çrregullime mendore që të jetë në martesë. Kjo mund të ndikojë në mënyrën se si fëmijët do të mundë të përjashtojnë nga rrethi i tyre i gjerë ose i ngushtë individë me vështirësi psikologjike, të frenojë rritjen e ndjenjës së empatisë dhe dëshirës për t'u ndihmuar njerëzve me çrregullime psikologjike dhe madje të vështirësojë përfshirjen në shoqëri të këtyre të fundit. Për më tepër, e drejta në martesë është e drejtë e cila mbrohet edhe me nenin 23 të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe një qasje për të drejtat e njeriut ka për fokus ndërmarrjen e masave për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara, përfshirë ata me aftësi të kufizuara mendore, gëzojnë të drejtat e tyre.³⁴ Kufizimet e së drejtës për t'u martuar duhet të bëhen vetëm për të mbrojtur interesat më të mira të njërit ose të të dy bashkëshortëve të mundshëm dhe kur ka arsye për të besuar se njëri ose të dy nuk janë në gjendje të japin miratimin e vlefshëm për martesë, për shkak të paaftësisë mendore, e cila dallon nga rasti në rast. Gjykime të tilla si në tekst, pa ofruar kontekstin e duhur, rrezikojnë krijimin e paragjykimeve për personat me aftësi të kufizuara mendore dhe/apo çrregullime psikologjike.

30. Në njësinë e radhës të po këtij kapitulli “Anët e errëta të jetës familjare”, është shkruar: “*Abuzimet seksuale me fëmijët dhe incestet janë dukuri të përhapura kryesisht në shoqëritë më të urbanizuara, të cilat përgjithësisht kanë më shumë njerëz të stresuar.*”³⁵ Qartazi ky

³¹ Blerim Latifi, Yllka Plasari (Myftiu), etj., Filozofi dhe logjikë 11 (për gjimnazin e shkencave natyrore), Prishtinë: Albas, 2020, fq. 106-138.

³² Yllka Plasari (Myftiu), Ilirjan Meta, Filozofi dhe logjikë (gjimnazi i shkencave shoqërore-gjuhësore), Prishtinë: Albas, 2022, fq. 53-69; 84-97; 128-138; 197-230.

³³ Muhamet Q. Mazreku, Sociologjia 11 (gjimnazi i shkencave shoqërore-gjuhësore), Prishtinë: Albas, 2019, fq. 115.

³⁴ OKB, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, neni 23.

³⁵ Po aty, fq. 117.

është një pohim që nuk mund të mbështetet dhe për më tepër i argumentuar në një mënyrë krejt formale, sepse abuzimet seksuale me fëmijët dhe incestet janë të evidentuara ose të përhapura në të gjitha shoqëritë dhe nuk ka ndonjë teori që abuzimet seksuale dhe incestin e shpjegon përmes nivelit të urbanizimit. Përveç kësaj, ndër shkaqet e këtyre abuzimeve nuk radhitet stresi. Ky arsyetim i përdorur normalizon abuzimin me fëmijë dhe incestin duke e shpjeguar si një pasojë nga stresi i madh i banorëve të zonave të urbanizuara. Për nxënësit ky është një informim jo i saktë dhe rrezikon të drejtat themelore të fëmijëve, duke e paralelizuar këtë formë të dhunës dhe të abuzimit seksual me një stil jetese të caktuar.

Sociologji 12

31. Ndryshe nga teksti i lëndës së Sociologjisë për klasën e 11-të, te teksti Sociologjia 12 nuk është evidentuar asnjë njësi mësimore, paragraf apo fjali që do të paraqiste problem në raport me fushën e të drejtave të njeriut. Përkundrazi, ky libër duhet parë si shembull për përdorimin e një gjuhe mjaft neutrale dhe të balancuar për sa u takon temave që lidhen me të drejtat e njeriut. Kjo vërehet lehtë sidomos në kapitullin “Religjioni në botën moderne”³⁶, ku janë shtjelluar në mënyrë të përgjithshme të gjitha format e religjioneve të shtrira në kohë dhe të para nga këndvështrime të ndryshme, e ku teksti është shumë i balancuar dhe në asnjë pikë të tij nuk rrëshqet dhe nuk merr trajta të njëanshme në drejtim të ndonjë religjioni specifik.

Psikologji

32. Te librat e lëndës së Psikologjisë për klasën e 11-të dhe të 12-të, ka njësi dhe kapituj të tërë ku trajtohen tema të të drejtave të njeriut. Por në këto njësi mësimore ka terminologji joadekuate, mungesë të shtjellimeve dhe të shembujve për konceptet përkatëse, të cilat mund të shkaktojnë keqkuptime tek fëmijët.

Psikologjia 11

33. Në njësinë mësimore “Agresiviteti dhe Sjellja Ndihmuese”, në faqen 130, shkruhet: *“Strategji të tjera të kontrollit të agresivitetit përfshijnë ndëshkimin e fëmijëve kur ata shfaqin sjellje të dhunshme dhe pakësimin e dhunës që ata shikojnë.”*³⁷ Në këtë pjesë mund të keqinterpretohet nga nxënësit se përdorimi i ndëshkimit kontrollon agresivitetin dhe shërben si strategji që përdoret te fëmijët. Ndëshkimi është një formë që mund të shtypë një sjellje të caktuar përbrenda një periudhe të shkurtër kohore, por nuk e largon krejtësisht sjelljen. Ndëshkimet çojnë në përfundime negative për të ndëshkuarin duke krijuar vetëvlerësim të ulët, dëmtim të mirëqenies emocionale, frikë, përshkallëzim të sjelljes/ve agresive, dhe duke shkaktuar vështirësi në zhvillimin e përgjithshëm.³⁸ Problemi i fjalisë së sipërcituar qëndron te fakti se mund të kuptohet si normale përdorimi i dhunës në edukimin e fëmijëve.

³⁶ Muhamet Mazreku, Sociologji 12 (për gjimnazin e shkencave shoqërore-gjuhësore), Prishtinë: Albas, 2021, fq. 35-50.

³⁷ Blerta Perolli Shehu, Ledianë Xhakollari etj., Psikologjia 11 (për gjimnazin shoqëror-gjuhësor dhe të shkencave natyrore), Prishtinë: Albas, 2023, fq. 130.

³⁴ Peets, Kätlin, Ernest VE Hodges, and Eve Kikas. "Unravelling the parent-child contexts in which corporal punishment predicts increases vs. decreases in children's aggression." *Journal of Clinical Child & Adolescent Psychology* 51, no. 2 (2022): 183-194.

³⁸ Peets, Kätlin, Ernest VE Hodges, and Eve Kikas. "Unravelling the parent-child contexts in which corporal punishment predicts increases vs. decreases in children's aggression." *Journal of Clinical Child & Adolescent Psychology* 51, no. 2 (2022): 183-194.

Psikologjia 12

34. Te ky libër janë të evidentuara raste të mungesës së shtjellimit të diskriminimit, të shembujve dhe mënyrave të vetëdijesimit dhe të parandalimit të sjelljeve diskriminuese. Në njësinë mësimore “Ndikimi i socio-kulturës në sjelljen njerëzore”,³⁹ ku shtjellohen stereotipat dhe paragjykimet, dhe diskriminimi përmendet si pasojë e koncepteve paraprake, por nuk jepen shpjegime mbi të, shembuj dhe strategji për t’i luftuar ato. Duke shpjeguar diskriminimin si koncept, nxënësit do të arrijnë të kuptojnë sjelljen që rrjedh si pasojë e qëndrimeve, stereotipave dhe paragjytimeve, të empatizojnë për grupet dhe individët e grupeve të tjera, të jenë të vetëdijshëm për qëndrimet, e rrjedhimisht për sjelljet e tyre dhe përgatitja për botën e jashtme se si të ballafaqohen me situatat diskriminuese. Kjo njësi mësimore është e paplotë në rolin e saj për edukimin e nxënësve mbi format e diskriminimit dhe parandalimit të sjelljeve diskriminuese.

35. Mungojnë shembuj dhe mënyra të propozuara se si të promovohet diversiteti në njësinë mësimore “Kultura dhe diversiteti”.⁴⁰ Përmes shtimit të strategjive për promovim të diversitetit dhe shembujve ilustrues, do të ofroreshin informata më të plota dhe të aplikueshme për fëmijët. Këto strategji promovuese janë të rëndësishme për luftimin e paragjytimeve dhe të diskriminimit, rritjen e empatisë, rritjen e të menduarit kritik.

36. Njësia mësimore “Diversiteti gjinor dhe seksual” është shkruar: “*Psikologët e përdorin termin “çrregullim i identitetit gjinor në rastet kur njerëzit ndiejnë shqetësim, mungesë të lumturisë dhe ankth për shkak të mospërputhjes mes trupit të tyre, apo seksit të tyre biologjik dhe identitetit gjinor që ndiejnë.*”⁴¹ Termi “çrregullim i identitetit gjinor” nuk është përdorur drejt, për arsye se ky term në Manualin Diagnostik dhe Statistikor të Çrregullimeve Mendore, Botimi i Pestë (DSM-5) është larguar fare dhe është zëvendësuar me termin “disfori gjinore”. Ky ndryshim ka ndodhur, sepse me çrregullim të identitetit gjinor, i cili është term klinik, fokusohet në problemin klinik të identitetit, kurse termi aktual në atë disforik. Disforia gjinore u referohet shqetësimeve që mund të vijnë nga mospërputhja e gjinisë që përjetojnë ose e shprehin me gjininë e paracaktuar. Ky ngatërrim i termave mund të shkaktojë informim të pasaktë të nxënësit gjatë edukimit të tyre për identitetin gjinor.

37. Në njësinë mësimore “Diskriminimi gjinor dhe seksual”⁴², në seksionin e diskriminimit gjinor mungojnë shembuj dhe shtjellime më të hollësishme për ndikimin negativ të normave dhe roleve gjinore të djemve dhe burrat. Është e rëndësishme për fëmijët që vështirësitë me normat dhe rolet gjinore që vijnë me të qenit vajzë ose grua, mund të jenë po kaq sfiduese për djemte dhe burrat. Fëmijët duhet ta kuptojnë se janë të barasvlershme të drejtat, detyrat dhe vështirësitë për të dy gjinitë.

KONSTATIMET

38. Avokati i Popullit, në bazë të vlerësimit dhe analizimit të teksteve shkollore të arsimit të mesëm të lartë, konstaton se niveli i përgjithshëm i teksteve shkollore në sistemin arsimor të nivelit të mesëm të lartë në Kosovë, në raport me fushën e të drejtave të njeriut, është i

³⁹ Blerta Perolli Shehu, Ledian Xhakollari, Psikologji 12 (gjimnazi i shkencave shoqërore-gjuhësore), Prishtinë: Albas, 2021, fq. 115 – 117.

⁴⁰ Po aty, fq. 123.

⁴¹ Po aty, fq. 125.

⁴² Po aty, fq. 124-126.

kënaqshëm, por ka mjaft hapësirë për përmirësime dhe për plotësime, që duhet të nisin nga kurrikulat e pastaj të reflektojnë te njësitë mësimore brenda teksteve.

39. Avokati i Popullit, në bazë të vlerësimit dhe analizimit të teksteve shkollore të arsimit të mesëm të lartë, konstaton se tekstet mësimore të lëndës Gjuhë shqipe dhe ato të lëndës Letërsi, për klasat 10, 11 dhe 12, nuk kanë përmbajtje që specifikisht do të ishte problematike në raport me fushën e të drejtave të njeriut.

40. Avokati i Popullit, në bazë të vlerësimit dhe analizimit të teksteve shkollore të arsimit të mesëm të lartë, konstaton se shumica e gjetjeve të këtij raporti, pra pjesët tekstuale të problematizuara në lidhje me të drejtat e njeriut, janë evidentuar në tekstet shkollore të lëndëve Edukatë qytetare, Histori, Sociologji dhe Psikologji, meqë ato kanë më së shumti njësi mësimore me përmbajtje nga fusha e të drejtave të njeriut.

41. Bazuar në të gjeturat nga analizimi i teksteve shkollore të arsimit të mesëm të lartë, rezulton se e përbashkëta e gjetjeve të këtij raporti, që është nxjerrë nga rastet e listuara në të, mund të përmblihet në dy pika, që mund të lexohen edhe si dy vërejtje: përdorimi joadekuat i nocioneve profesionale nga fushat e të drejtave të njeriut, përkatësisht mosunifikimi i terminologjisë, gjegjësisht përdorimet me disa kuptime dhe nënkuptime të ndryshme të fjalorit profesional të fushës së të drejtave të njeriut; dhe shtjellimi i pamjaftueshëm si dhe shembujt e paktë ilustrues për format e shkeljeve dhe mbrojtjeve të të drejtave të njeriut.

42. Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.”* Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: *“[...] ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla [...].”*, prandaj i

REKOMADON

Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit:

1. Të unifikohet gjuha terminologjike, përkatësisht përdorimi i termave dhe i koncepteve kyçe, me të cilat operohet në fjalorët e sociologjisë, psikologjisë dhe edukatës qytetare, në raport me fushën e të drejtave të njeriut. Të shtjellohen sa më qartë, me shembuj dhe me shpjegime shtesë edhe në formë fjalorthësh specifikë me fjalë të reja për nxënësit, si dhe të përshtaten shembujt me kontekstet sociale dhe kulturore të shoqërisë në Kosovë, ashtu që fenomenet dhe termat të jenë të qartë, të kuptueshëm dhe pa lënë hapësirë keqkuptimesh për nxënësit.
2. Duke u bazuar në gjetjet e këtij raporti, të ndërmerren masa për eliminimin e të gjitha fjalëve apo termave, fjalive apo paragrafëve me përmbajtje të papërshtatshme që

përmbajnë ide apo që nxisin dhe kultivojnë ide që shkojnë kundër frymës së njohjes dhe respektimit të fushave të të drejtave të njeriut.⁴³

3. Në kurrikulën për tekstin e lëndës së Historisë, për klasën e 12-të, ku janë përfshirë mësimet nga historia moderne dhe bashkëkohore, të përcaktohen njësi të veçanta mësimore për historinë e të drejtave të njeriut; për lëvizjet shoqërore të sindikatave që kanë avokuar për të drejtat e punëtorëve; për valët e feminizmit që janë angazhuar për të drejtat e grave dhe për barazi gjinore; për konventat ndërkombëtare, rezolutat dhe dokumentet e tjera relevante për të drejtat e njeriut.
4. Është me rëndësi që shkeljet e të drejtave të njeriut gjatë luftës në Kosovë, që u referohen krimeve të kryera gjatë saj, krimeve kundër njerëzimit dhe akteve gjenocidale, të pasqyrohen në lëndët Histori dhe Edukatë qytetare. Kjo pasi një nga fushat kyçe për të drejtat e njeriut është ajo që lidhet me Krimet e Luftës dhe Krimet Kundër Njerëzimit, duke përfshirë Gjenocidin, të normuara veçanërisht me Konventën mbi Prandalimin dhe Ndëshkimin e Krimeve të Gjenocidit (1948) dhe Konventën Relative të Gjenevës për Mbrojtjen e Personave Civilë në Kohë Luftë (1949).

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe në pajtim me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit

⁴³ Si shembull i nxjerrë nga ky raport, shih gjetjen në paragrafin 30 të këtij raporti, përkatësisht fjalinë e tekstit Sociologjia 11: “Abuzimet seksuale me fëmijët dhe incestet janë dukuri të përhapura kryesisht në shoqëritë më të urbanizuara, të cilat përgjithësisht kanë më shumë njerëz të stresuar.”